

VLERËSIMI PËRSHKRUES

Përgatiti: Msc. Irida Sina

Irida.sina@gmail.com

Drp. Aurela Zisi

aurelazisi@yahoo.com

SHPJEGIMI I KONCEPTIT

- Vlerësimi përshtetshëm shërben për të vlerësuar me korrektësi arritjet e nxënësit dhe nevojat e tij për përmirësim.
- Arritjet bazohen në përmbushjen e objektivave specifike që ka secila linjë programi për çdo lëndë të klasës së tretë (me kurrikulën aktuale).



TË PËRGJITHSHME

- Portofoli përmban një koleksion punimesh të kryera si në mënyrë individuale dhe në bashkëpunim me të tjerët (detyra shtëpie me shkrim, punime tematike, projekte kurrikulare, fotografi teste etj...).
- Mësuesi vlerëson në të njëjtën formë, testet dhe detyrat e kontrollit të secilit nxënës.



Shkallët e vlerësimit



SHKALLA 1.

“ARRITJE TË PAKËNAQSHME”

- Nxënësi nuk përmbush asnjë nga objektivat bazë të të nxënit.
- Plotëson *pak* detyra.
- Ka nevojë të kujtohet shpesh për të bërë detyrat dhe është *rrallë herë* i motivuar.
- Detyrat i mungojnë, janë *të paplotësuara*, të pasakta dhe mund t'i dorëzojë *me vonesë*.
- *Rrallë* dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutimet në klasë dhe në bashkëpunim me shokët.



SHKALLA 2: “ARRITJE QË KANË NEVOJË PËR PËRMIRËSIM”

- **Nxënësi arrin vetëm pak nga objektivat bazë të të nxënit, (kërkon mbështetje dhe punë të vazhdueshme nga ana e mësuesit).**
- Është i motivuar për të plotësuar detyrat, megjithatë *disa prej tyre* mund të mos zhvillohen plotësisht.
- *Herë pas here* duhet kujtuar që të bëjë detyrat.
- *Ndonjëherë* dëgjon me vëmendje dhe merr pjesë në aktivitete dhe diskutime në klasë dhe punon bashkërisht në grupe.



SHKALLA 3

“ARRITJE TË KËNAQSHME”

- **Nxënësi përmbush objektivat bazë të të nxënimit dhe, me mbështetjen e mësuesit, vazhdon të bëjë përparime.**
- *Zakonisht* është i motivuar dhe i përqendruar në detyra.
- I plotëson detyrat në kohë.
- *Zakonisht* dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe në aktivitetet e klasës dhe punon bashkërisht në grupe.



SHKALLA 4.

“ARRITJE SHUMË TË KËNAQSHME”

- **Nxënësi përmbush pjesën më të madhe të objektivave të të nxënit.**
 - është i vetë-motivuar.
 - I plotëson detyrat me kënaqësi.
 - *Shpesh* kërkon dhe vihet përpara sfidave.
 - *Thuajse* gjithmonë dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe në aktivitetet e klasës dhe punon bashkërisht në grupe.



SHKALLA 5.

“ARRITJE TË SHKËLQYERA”

- **Nxënësi i përmbush të gjitha objektivat e të nxënimit.**
 - Është i vetëdrejtuar.
 - Kërkon sfida.
 - Plotëson *çdo* detyrë me entuziazëm.
 - Dëgjon me vëmendje.
 - Merr pjesë *me entuziazëm* në diskutim dhe në aktivitetet e klasës.
 - Kontribuon në ndërveprimin efektiv të grupeve bashkëvepruese.
 - Merr përgjegjësi për të zgjeruar rritjen personale dhe akademike.



PLOTËSIMI I REGJISTRIT (SIPAS FORMATIT TË RI TË VLERËSIMIT PËRSHKRUES)

G:\Plotësimi i regjistrit sipas formatit të ri të
vlerësimit përshkrues.docx

- Vlerësimi përmbledhës në klasën e tretë do të jetë vetëm **VJETOR** jo semestral.



VLERËSIMI SIPAS LËNDËVE

- G:\Vlerësimi përshkrues sipas lëndëve mësimore.docx



PYETJE

- VLERËSIMI NËPËRMJET PORTOFOLIT
- PLOTËSIMI I REGJISTRIT
- KONCEPTIMI I REGJISTRIT TË RI

